

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji i përbërë nga gjyqtaret Shqipe Qerimi kryetare, Rasim Rasimi dhe Gani Zabeli anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Y.K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 409 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1178/2016, të datës 22.08.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.02.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1178/16, i datës 22.08.2016 përkritazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin Y.K. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, e dënon me dënim me gjobë në shumën prej 1000 (njëmijë) euro, të cilën gjobë është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 dite, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, e nëse nuk e paguan ky dënim i zëvendësohet me burg, duke ia llogaritur për çdo 20 euro me një ditë burg.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin, P.nr.1178/2016 të datës 22.08.2016, të akuzuarin Y.K. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 409 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së, për të cilën vepër e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve), në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej dates 29.05.2016 e deri me 16.06.2016. Me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burgim i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 300 (treqindë) Euro. Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me dhunë, i njejt i do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 euro me një ditë burg.

Është Obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 40 Euro, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë themelore në Prizren, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë me gjobë .

Prokurori i Prokurorisë së Apelit me parashtresën PPA/II.nr.1514/16, të datës 07.12.2016, ka propozuar që ankesa Prokurorit të Prokurorisë Themelore të aprovohet si e bazuar, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më të ashpër dhe atë me burg efektiv.

Gjykata e Apelit pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, dhe gjeti se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të Ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase siç rezulton nga shkresat e lëndës i akuzuari e ka pranuar fajësinë, prandaj, sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë, ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, andaj ankesa e mbrojtësi të akuzuarit për këtë bazë është e palejuar.

Përkitazi me vendimin mbi dënimin, në ankesën e Prokurorit theksohet se, se dënimi i shqiptuar për të akuzuarin është i butë , meqenëse Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, ka pasur parasysh vetëm rrethanat lehtësuese ndërsa rrethanat rënduese fare nuk i ka marr në shqyrtim, si kundër është pesha e veprës penale , rrezikshmëria shoqërore e kësaj vepre penale e cila është në rritje e sipër dhe e theksuar si dukuri negative në shoqërinë tonë, është një vepër serioze e drejtuar kundër rendit publik, ndaj zyrtarëve policor gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese ka marrë për bazë pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte të tij pas kryerjes së veprës penale,

pendimin e thellë të tij, gjer më tani i pagjykuar, vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit.

Rrethanat lehtësuese të cilat i ka marrë për bazë gjykata e shkallës së parë i pranon edhe kjo gjykatë, por konsideron se rrethanat e këtilla duke pasur parasysh peshën e veprës penale nuk e justifikojnë shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur si të mjaftueshëm për arritjen e shqiptimit të dënimit, ngase nuk janë në proporcion me intensitetin e të mirës së mbrojtur, e as me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, prandaj kjo gjykatë duke e aprovuar ankesën e Prokurorit e duke i pasur për bazë edhe rrethanat e lartë cekura të akuzuarin e gjykoi me dënim me gjobë në shumë prej 1000 € (njëmijë euro), me bindje se ky dënim është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventivës individuale dhe gjenerale, dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat ligjore.

Nga kjo që u tha më lartë e në bazë të nenit 403 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- PRISHTINË
PA1nr.1407/2016, me date 16.02.2017

Procesmbajtësi,

Hysni Ismaili

Anëtarët e kolegjit,

1. Rasim Rasimi

2. Gani Zabeli

Kryetari i kolegjit,

Shqipe Qerimi